

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“ALESIA CLEAN” SHPK**

**Neni 1: Emri dhe forma ligjore**

Sot më datë 06.02.2024, unë i nënshkruari:

**Zef DEMA**, i datëlindjes 06.05.1993, lindur ne Iballe, madhore dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi J05060090

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin :

**“ALESIA CLEAN “ SHPK**

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit,Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”, i ndryshuar

**Neni 2: Selia**

**Lagjja 4, Rruga Petraq Boshnjaku, Godina nr. 149, Kati perdhe, Durrës.**



Shoqëria mund të hapë edhe seli të tjera operative, filiale, përfaqësi dhe agjensi në të gjithë territorin e Shqipërisë si dhe jashtë saj, në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe ligjet e vendeve ku ato hapen.

### **Neni 3: Objekti**

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Shërbime në fushën e pastrimit, dezinfektimit, dhe mirembajtjes së të gjithë llojeve të objekteve, brenda dhe jashtë vendit, si: Institucionet bankare, objekte qeveritare, spitale dhe objekte mjekësore, qendra biznesi, komplekse argetimi dhe salla të lojërave të fatit, call center, apartamente, vila, dhe shtëpi, hotele, supermarkete, shkolla, universitete publike dhe private, bar, restorante, palestra, magazina, fabrika, aeroporte etj. Mirembajtje hapsirash të gjelbërta dhe sistemim të tyre.
- Tregtim, Import ekport i makinerive dhe pajisjeve që shërbejnë pastrim.
- Tregtim materialeve të pastrimit, dezinfektimit, detergjentëve të ndryshme, etj.
- Transport mallrash për vehte për të treta e me qira.
- Tregtim artikuj të ndryshëm industrial.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejueshëm për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohet me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt.14.04-08).

### **Neni 4: Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.



### **Neni 5: Kapitali**

Kapitali i shoqërisë është 10.000 (njëqindmije) LEKE, i ndarë në 1 kuota.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

1. **Zef DEMA**, është zotëruese e 1 kuote, me 100% pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlerën 10.000 leke.

### **Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë**

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Zef DEMA**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

### **Neni 7: Viti ushtrimor**

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

### **Neni 8: Dispozitat e fundit**

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti. Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakëve të Shoqërisë

**Zef DEMA**

